

VENDIM
Nr. 81, datë 16.12.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryesuese;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 12.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (D) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Deshire Subashi, përfaqësuar nga avokate Evelina Qirjako, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA

Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Xhelal Kasaj, Ornela Marku, Erjon Ndreca, Albiona Toçi, me autorizim.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, përfaqësuar nga kryetari, Ilir Rusi.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësuar nga komisioneri Robert Gajda.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4992, datë 17.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 5, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases Deshire Subashi (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGG*), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, i cili e ka lënë në çmim të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) rrëzimin ose pranimin e kërkesës, mendimin me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*KMD*), i cili nuk ka mbajtur qëndrim në lidhje me çështjen konkrete, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja rezulton se është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë me vendimin nr. 3, datë 23.2.1993, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*KLD*). Po ashtu, rezulton se me

vendimin nr. 146, datë 4.9.2003 të KLD-së kërkuesja është zgjedhur anëtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me mandat 7-vjeçar. Në këtë kohë në fuqi ka qenë Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.6.2003. Përgjatë ushtrimit të këtij mandati ka hyrë në fuqi ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i cili sillte si pasojë ligjore ndërprerjen para kohe të mandatit të kërkueses si anëtare e KQZ-së. Në datën 2.2.2009 kërkuesja është rizgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë anëtare e KQZ-së, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në përfundim të mandatit të saj, në muajin tetor të vitit 2012.

2. Pas përfundimit të mandatit si anëtare e KQZ-së, kërkuesja rezulton t’i jetë drejtuar tri herë KLD-së për t’u rikthyer në pozicionin e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë, të cilin ajo e ka ushtruar deri para kohës së emërimit të saj në detyrën e anëtarit të KQZ-së. Po ashtu, rezulton se KLD-ja nuk i ka marrë asnjëherë në shqyrtim këto kërkesa të kërkueses. Ndërkohë, gjatë kohës së parashtrimit të kërkesave nga kërkuesja, rezulton që nga KLD-ja janë shpallur vende vakante pikërisht për emërim në detyrën e gjyqtarit në gjykatën e apelit. Pra, nga koha e paraqitjes së kërkesës për t’u rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës nga kërkuesja pranë KLD-së, deri në paraqitjen për gjykim të kërkesëpadisë është provuar dhe pranuar në gjykimin në gjykatat e zakonshme se nga pala e paditur, KLD-ja, janë bërë emërim në gjykatën e apelit. Në të njëjtën kohë rezulton se KLD-ja ka marrë në shqyrtim kërkesa edhe të ish-anëtarëve të tjerë të KQZ-së, për rikthimin e tyre në detyrat që ata kishin ushtruar para fillimit të emërimit dhe të ushtrimit të mandatit si anëtarë të KQZ-së.

3. Në këto rrethana, referuar faktit se kërkesa e saj nuk është marrë asnjëherë në shqyrtim nga KLD-ja, kërkuesja ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt konstatimin e diskriminimit, ndreqjen e shkeljes së ligjit dhe shpërblimin e dëmit material dhe moral, si dhe detyrimin e KLD-së të marrë në shqyrtim kërkesën dhe të vendosë emërimin e saj në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 7462, datë 17.12.2014, ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Konstatimin e diskriminimit për shkak të mosmarrjes në shqyrtim të kërkesës së palës paditëse nga ana e palës së paditur, KLD-së. Detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses. Detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të dëmshpërblejë moralisht paditësen në masën një milion lekë, për shkak të konstatimit të diskriminimit [...]”. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim pala e paditur, KLD-ja, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1106, datë 16.3.2017 (*vendimi i themelit*), ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 7462, datë 17.12.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; pranimin e pjesshëm të padisë; detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të dëmshpërblejë paditësen për dëmin pasuror të shkaktuar, duke i kompensuar pagën mbi pagën e përfituar në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8097, datë 23.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” (*ligji nr. 8097/1996*), deri në nivelin e pagës referuese të funksionit si nënkryetare e KQZ-së, për periudhën nga data 1.1.2013 deri në datën 1.1.2016. Rrëzimin e padisë në kërkimet e tjera [...]”. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesja, si dhe pala e paditur në proces, KLD-ja.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3621 (370), datë 24.9.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të themelit për sa i përket kërimit për konstatimin e diskriminimit dhe shpërblimin e dëmit për këtë shkak, dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit, me tjetër trup gjykues, si dhe lënien në fuqi të vendimit të themelit për pjesën tjetër. Kolegji Administrativ ka arsyetuar se, në lidhje me kërkimin e kërkueses për konstatimin e diskriminimit dhe shpërblimin e dëmit për këtë shkak, Gjykata Administrative e Apelit, në rigjykimin e çështjes, duhet të zgjidhë mosmarrëveshjen në

themel, të kryejë një cilësim të saktë të fakteve dhe rrethanave në këtë mosmarrëveshje, si dhe t'u japë përgjigje pretendimeve të palëve ndërgjyqëse për ta zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me ligjin dhe normat e tjera në fuqi. Po sipas Kolegjit Administrativ, pjesa tjetër e vendimit të themelit që ka disponuar për dëmshpërblimin e kërkuar duhet të lihet në fuqi.

7. Po ashtu, rezulton se pala e paditur, KLD-ja, ka kërkuar nga Gjykata Administrative e Apelit sqarimin e pikës 3 të dispozitivit të vendimit të themelit për urdhërimin: “Detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të dëmshpërblejë paditësen për dëmin pasuror të shkaktuar, duke i kompensuar pagën mbi pagën e përfituar në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8097/1996, deri në nivelin e pagës referuese të funksionit si nënkryetare e KQZ-së, për periudhën nga data 1.1.2013 deri në datën 1.1.2016”, duke kërkuar nga gjykata se cila është masa e dëmshpërblimit e caktuar prej saj.

8. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 375, datë 20.12.2017 (*vendimi i sqarimit*), ka sqaruar se dëmi që pala e paditur detyrohet t'i paguajë paditëses (kërkuar), në zbatim të vendimit të themelit, është shuma që do të rezultojë nga diferenca ndërmjet pagës referuese për pozicionin e nënkryetares së KQZ-së dhe përfitimit që ajo ka marrë në masën 50% të pagës referuese në zbatim të ligjit nr. 8097/1996.

9. Ndaj vendimit të sqarimit ka paraqitur rekurs kërkuar, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 13.2.2018. Krahas rekursit, rezulton se kërkuar ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë edhe dy akte të titulluara “Notë verbale”, të cilat mbajnë datat 18.9.2024 dhe 22.10.2024. Sipas këtyre akteve, si fillim kërkuar ka parashtruar kundërshtimet e saj në lidhje me vendimin e sqarimit të gjykatës së apelit, duke i kërkuar Gjykatës së Lartë bashkimin e kësaj çështjeje me atë të gjykimit të themelit të kërkesëpadisë (akti i datës 18.9.2024), ndërsa në vijim, me aktin e datës 22.10.2024, i ka kërkuar Gjykatës së Lartë se duke qenë se kjo e fundit e ka zgjidhur çështjen e saj të themelit, çështja tjetër me objekt “Sqarimi dhe interpretimi i vendimit të themelit” ka rënë dhe nuk ka më objekt. Për këtë arsye, kërkuar i ka kërkuar Gjykatës së Lartë pushimin e gjykimit të kësaj çështjeje.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4992, datë 17.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se kërkuar, me shkresat nr. 5210 prot., datë 22.10.2024 dhe nr. 5239 prot., datë 24.10.2024, ka kërkuar pushimin e çështjes, bazuar në nenin 490 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Për këtë arsye, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se nuk ka vend për trajtimin e mëtejshëm të shkaqeve të rekursit, për shkak të heqjes dorë prej tij.

11. Në datën 13.3.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuar i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, i cili është regjistruar në datën 17.3.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 23.4.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

12. Në datën 26.11.2025, një prej gjyqtarëve të Gjykatës, bazuar në nenin 36, pika 1, shkronja “ç”, të Ligjit Organik të saj dhe nenin 18, pika 1, shkronja “ç”, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, kërkesë e cila është pranuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës në të njëjtën datë.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. Kërkuarja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se është cenuar:

13.1. *E drejta e aksesit dhe e drejta e ankimit efektiv*, pasi kërkuar në asnjë moment nuk ka hequr dorë nga shqyrtimi i çështjes së saj në Gjykatën e Lartë. Heqja dorë është supozuar

nga vetë Gjykata e Lartë, ndërkohë që kërkesja nuk ka shfaqur asnjë vullnet për të hequr dorë nga shqyrtimi i rekursit të saj. Po ashtu, rezulton se nga të gjitha aktet e paraqitura nga kërkesja në Gjykatën e Lartë, nuk shfaqet vullneti i saj për të hequr dorë nga rekursi. Këto të drejta janë cenuar edhe për faktin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit bazuar nën një prezumim të gabuar se kërkesja kishte hequr dorë nga e drejta e rekursit.

13.2. *Parimi i disponibilitetit dhe e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi nga notat verbale të depozituara nëpërmjet e-mail-it nga përfaqësuesja e kërkeses, në asnjë rresht të tyre nuk përmendet termi “heqje dorë” nga rekursi dhe as neni 490 i KPC-së. Shkaku i këtyre notave verbale ka qenë që në mbështetje të rekursit të paraqitur nga kërkesja me objekt “Prishjen e vendimit të sqarimit dhe pushimin e gjykimit”, të evidentohet disponimi i vendimit të themelit për dëmin pasuror, i cili ishte i ligjshëm dhe u konfirmua nga Gjykata e Lartë tre muaj përpara me vendimin nr. 00-2024-3621 (370), datë 24.9.2024. Pra, baza dhe shkaku i notave verbale ka qenë pushimi i gjykimit të çështjes për kërkesën për sqarim vendimi, si çështje e mbetur pa objekt dhe gjykimi i së cilës nuk mund të vazhdonte bazuar në dispozitat procedurale. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka vendosur *ultra petita* mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkesja, pa ushtruar asnjëherë kjo e fundit deponimin e kësaj të drejte nëpërmjet kërkesës për heqje dorë nga rekursi, në përputhje me nenin 490 të KPC-së. Nota verbale e kërkeses është dërguar prej saj pranë Gjykatës së Lartë në formë të skanuar, ndërsa nga përfaqësuesja e kërkeses është nënshkruar pa tagra përfaqësimi për të hequr dorë nga rekursi, pasi prokura për përfaqësuesen e legjitimonte këtë të fundit vetëm për gjykimin e themelit të çështjes. Nota verbale nga përfaqësuesja është dërguar me qëllim informimin e Gjykatës së Lartë për gjykimin tjetër të zhvilluar pranë saj.

13.3. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë, duke deformuar vullnetin e kërkeses, e ka privuar atë nga pritshmëritë e ligjshme të krijuara për çështjen e saj, si dhe nga garantimi i realizimit të së drejtës për mbrojtje efektive përpara një gjykate të caktuar me ligj. Në këtë rast, Gjykata e Lartë ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin në aspektin substancial dhe material. Po ashtu, në rastin konkret është krijuar një anomali juridike, ku për të njëjtën çështje dhe me të njëjtat palë, ekzistojnë dy vendime të së njëjtës gjykatë që disponon në mënyra të ndryshme. Nga njëra anë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin e themelit të gjykatës së apelit në lidhje me të drejtën për të përfutur pagën e plotë për periudhën nga data 1.1.2013 deri në datën 1.1.2016, dhe nga ana tjetër, me vendimin objekt të këtij gjykimi kushtetues, për shkak të mospranimit të rekursit, si pasojë e heqjes dorë (sipas Kolegjit Administrativ), ka lënë në fuqi vendimin e sqarimit, i cili ka përgjysmuar vlerën e dëmit pasuror që i është njohur kërkeses me vendimin e themelit.

14. *Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë*, e ka lënë vlerësimin e çështjes në çmim të Gjykatës.

15. *Subjekti i interesuar, KLGJ-ja*, ka parashtruar se pretendimet e kërkeses nuk janë të bazuara, pasi ajo ka paraqitur rekurs, si dhe nota verbale, mbi bazën e të cilave ka shprehur qëndrimin e saj për çështjen. Po ashtu, Kolegji Administrativ në rastin konkret nuk ka disponuar me dy vendimmarrje të ndryshme, por një çështje të kërkeses e ka zgjidhur në themel, duke e dërguar për rigjykim në gjykatën e apelit, ndërsa për tjetrën, bazuar në notat verbale të saj, nuk u ka hyrë shkaqeve të rekursit.

16. *Subjekti i interesuar, KMD-ja*, ka parashtruar se duke qenë se çështja objekt i këtij gjykimi kushtetues nuk lidhet me cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, ka vlerësuar mos të mbajë qëndrim në lidhje me pretendimet e kërkeses, por ka paraqitur një mendim me shkrim, duke evidentuar garancitë që ofron ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

17. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Në këtë këndvështrim, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

19. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Cenimi i të drejtave themelore mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte. Ky rregull, në thelb, synon t’u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshtëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuësja ka paraqitur ankim kushtetues, me objekt kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit të saj ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit që kishte disponuar për sqarimin dhe interpretimin e vendimit të themelit. Për nga natyra dhe qëllimi, ky lloj vendimi i bashkohet si pjesë përbërëse vendimit përfundimtar që ka disponuar për themelin e çështjes së kërkuësës, pra për të drejtën e dëmshpërblimit të saj. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ajo e ka përmbushur këtë kriter, pasi nuk ka më mjete të tjera ankimi në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, të pretenduara si të cenuara.

21. Kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 17.12.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 13.3.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra brenda afatit 4-mujor.

22. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit dhe së drejtës së ankimit efektiv, parimit të disponibilitetit dhe atij të sigurisë juridike, si dhe së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, për shkak se, sipas saj, Gjykata e Lartë, duke i konsideruar kërkesat e saj të shprehura në aktet “Notë verbale” si heqje dorë nga gjykimi i çështjes, i ka deformuar vullnetin.

23. Për sa më lart, Gjykata, duke mbajtur parasysh natyrën dhe përmbajtjen e argumenteve të parashtruara në mbështetje të këtyre pretendimeve të kërkuësës, vlerëson se ato, në thelb, kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, ndaj, në vijim, do ta shqyrtojë çështjen në themel në këtë drejtim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

24. Kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka konsideruar kërkesat e saj të paraqitura në atë gjykatë si kërkesa për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, ndërkohë që ajo në asnjë moment nuk e ka kërkuar një gjë të tillë. Sipas kërkueses, në këtë rast heqja dorë është supozuar nga vetë Gjykata e Lartë, pasi ajo nuk ka shfaqur asnjë vullnet për të hequr dorë nga shqyrtimi i rekursit të saj. Në këtë kuptim, kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka deformuar vullnetin e saj, duke e privuar nga pritshmëritë e ligjshme të krijuara për çështjen.

25. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka parashtruar se Kolegji Administrativ në rastin e kërkueses nuk ka disponuar me dy vendimmarrje të ndryshme, por një çështje të saj e ka zgjidhur në themel, ndërsa për tjetrën nuk u ka hyrë shkaqeve të rekursit. Ndërkohë, subjekti tjetër i interesuar, KMD-ja, ka vlerësuar mos të mbajë qëndrim në lidhje me pretendimet e kërkueses, ndërsa subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, e ka lënë vlerësimin e çështjes në çmim të Gjykatës.

26. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës ka parashikuar se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

27. Lidhur me të drejtën e aksesit, Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 17, datë 24.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 5.11.2025; nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 5.11.2025; nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Bazuar në standardet kushtetuese të lartpërmendura dhe nisur nga konteksti i rrethanave të çështjes, në rastin konkret Gjykata do të analizojë aktet e paraqitura nga kërkuesja (notat verbale) pranë Gjykatës së Lartë, pas depozitimit të rekursit dhe vlerësimin që u ka bërë kjo e fundit atyre, për të arritur në përfundimin nëse ky vlerësim përkon me vullnetin e kërkueses. Për këtë arsye, Gjykata do të analizojë edhe arsyetimin e bërë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e kundërshtuar nga kërkuesja, për të

vlerësuar nëse kërkueses i është cenuar e drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

30. Gjykata vëren se për kërkesëpadinë e kërkueses Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke disponuar, ndër të tjera, detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të marrë në shqyrtim kërkesën e paditëses, si dhe detyrimin e palës së paditur, KLD-së, të dëmshpërblejë moralisht paditësen në masën një milion lekë, për shkak të konstatimit të diskriminimit. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata Administrative e Apelit, për sa i përket masës së dëmshpërblimit që përfiton kërkuesja (vendimi i themelit), duke disponuar se KLD-ja duhet ta dëmshpërblejë atë për dëmin pasuror të shkaktuar, duke i kompensuar pagën mbi pagën e përfituar në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8097/1996 deri në nivelin e pagës referuese të funksionit si nënkryetare e KQZ-së, për periudhën nga data 1.1.2013 deri në datën 1.1.2016. Ndërkohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në datën 24.9.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të themelit të gjykatës së apelit vetëm për sa i përket kërimit për konstatimin e diskriminimit dhe shpërblimin për këtë shkak, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e apelit, ndërsa e ka lënë në fuqi atë vendim për pjesën tjetër, për sa i përket dëmshpërblimit të kërkueses në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8097/1996.

31. Gjykata Administrative e Apelit, pas kërkesës së KLGj-së për sqarimin dhe interpretimin prej saj të vendimit të themelit, ka sqaruar me vendim dispozitivin e vendimit (të themelit). Ndaj këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs. Referuar materialeve bashkëlidhur kërkesës, Gjykata konstaton se kërkuesja, krahas rekursit, ka paraqitur pranë Gjykatës së Lartë edhe dy akte të tjera të titulluara “Notë verbale” të datës 18.9.2024 (akti i parë) dhe të datës 22.10.2024 (akti i dytë).

32. Referuar këtyre akteve, Gjykata konstaton se kërkuesja në aktin e parë, si fillim ka parashtruar kundërshtimet e saj në lidhje me vendimin e sqarimit të gjykatës së apelit, duke i kërkuar Gjykatës së Lartë bashkimin e kësaj çështjeje me atë të gjykimit të themelit të kërkesëpadisë. Gjithashtu, kërkuesja ka vijuar me pretendimet e saj në lidhje me kërkesëpadinë e çështjes së themelit, duke i kërkuar në përfundim Gjykatës së Lartë “pranimin e rekursit të pjesshëm të saj” për çështjen e themelit. Ndërsa, referuar aktit të dytë, Gjykata vëren se kërkuesja i ka parashtruar Gjykatës së Lartë se kjo e fundit, me vendimin e datës 24.9.2024, e ka zgjidhur themelin e kërkesëpadisë së saj. Në këto kushte, referuar të njëjtit akt, sipas kërkueses, çështja që do të shqyrtohej nga Gjykata e Lartë, me objekt “Sqarimi dhe interpretimi i vendimit nr. 1106, datë 16.3.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit”, ka rënë dhe nuk ka më objekt. Si konkluzion, në aktin e dytë, kërkuesja i ka kërkuar Gjykatës së Lartë që *“pasi të marrë në shqyrtim çështjen, të vendosë pushimin e gjykimit të saj, në kushtet kur çështja e themelit tashmë është zgjidhur me vendim përfundimtar të formës së prerë të datës 24.9.2024, të Gjykatës së Lartë dhe, si pasojë, çështja me objekt “sqarim/interpretim” në datën e zhvillimit të gjykimit paraqitet pa objekt”*.

33. Në lidhje me këto kërkesa të kërkueses, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4992, datë 17.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit për çështjen me objekt sqarimin dhe interpretimin e vendimit të themelit, duke vlerësuar se kërkuesja, me shkresat nr. 5210 prot., datë 22.10.2024 dhe nr. 5239 prot., datë 24.10.2024, ka kërkuar pushimin e çështjes, bazuar në nenin 490 të KPC-së dhe për këtë arsye ka vlerësuar se nuk ka vend për trajtimin e mëtejshëm të shkaqeve të rekursit, për shkak të heqjes dorë prej tij (*shih paragrafin 11 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

34. Ndërkohë, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, Gjykata vëren se rezulton e administruar vetëm shkresa “Notë verbale” nr. 5210 prot., datë 22.10.2024. Për këtë arsye, Gjykatës së Lartë iu kërkuar nga Gjykata të vinte në dispozicion një kopje të shkresës nr. 5239 prot., datë 24.10.2024, të depozituar nga kërkuesja dhe të cituar në vendimin e Kolegjit Administrativ. Në përgjigjen e saj Gjykata e Lartë ka

informuar se ky akt është dërguar në rrugë elektronike në një nga adresat e asaj gjykate, i cili është protokolluar me ato ekstremitete, por nuk rezulton të jetë administruar në dosjen gjyqësore dhe ka të njëjtën përmbajtje si shkresa nr. 5210 prot., datë 22.10.2024, e depozituar nga kërkuesja në rrugë shkresore, dhe të dyja bashkë janë përmendur në vendimin e Kolegjit Administrativ.

35. Nisur nga sa më lart, Gjykata konstaton se nëpërmjet aktit nr. 5210 prot., datë 22.10.2024 (akti i dytë), nuk rezulton që kërkuesja të ketë hequr dorë nga shqyrtimi i rekursit. Jo vetëm kaq, por sipas këtij akti, Gjykata vëren se kërkuesja nuk i është referuar asnjëherë si bazë ligjore nenit 490 të KPC-së (rastet e heqjes dorë nga rekursi), as në formë dhe as në përmbajtje, por e gjendur përballë faktit se çështja e themelit ishte zgjidhur tashmë nga i njëjti kolegji i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3621 (370), datë 24.9.2024, i ka kërkuar kësaj të fundit të pushojë çështjen me objekt sqarimin dhe interpretimin e vendimit të themelit, pasi kishte mbetur pa objekt.

36. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se qartazi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të kishte vlerësuar me kujdes përmbajtjen e aktit/memories së depozituar nga pala, për të arritur në përfundimin se kërkuesja kërkonte pushimin e gjykimit, për shkak se çështja kishte mbetur pa objekt, duke iu referuar në fakt parashikimit të nenit 299, shkronja “c”, të KPC-së, sipas të cilit në rastet kur gjykimi nuk mund të vijojë më dhe kjo konstatohet prej gjykatave më të larta, ato prishin vendimin e gjykatës më të ulët dhe pushojnë çështjen. Kërkuesja kishte kundërshtime për vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit që shprehej për sqarimin dhe interpretimin e vendimit të themelit, por meqenëse ndërkohë themeli i çështjes ishte vendosur (për shkak të vendimmarrjes së mëparshme të Gjykatës së Lartë), diskutimi dhe gjykimi i rekursit kundër vendimit nr. 375, datë 20.12.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit (*vendimi i sqarimit*), nuk kishte më kuptim. Për rrjedhojë, Gjykata evidenton se me vlerësimin që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka bërë aktit nr. 5210 prot., datë 22.10.2024, nuk ka analizuar drejt vullnetin e shprehur nga kërkuesja në të, duke sjellë si pasojë edhe cenimin e së drejtës së aksesit. Kjo do të thotë se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke interpretuar në mënyrë të pakujdesshme vullnetin e kërkueses, për rrjedhojë duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk u ka dhënë në substancë përgjigje pretendimeve të saj.

37. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, prandaj ankimi kushtetues individual i saj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4992, datë 17.12.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.12.2025.
Shpallur më 23.1.2026.

Kryesuese: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Sonila Bejtja, Asim
Vokshi